

PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUARA

Automjetet për personat me aftësi të kufizuara

Baza ligjore: Kodi Nr. 03/L-109, Doganor dhe i Akcizave Në Kosovë, Aneksi 'A' Neni 78, paragrafi 1 dhe 2. Dokumentet e nevojshme

- Vendimin nga organi kompetent apo Komisioni (mendimin e konzoliumit të mjekeve të QKUK-së) që konfirmon vërtetimin e dëmtimit trupor.
- Ne rast se personi është përfitues i pensionit invalidore vendimin nga Ministria për Punë dhe mirëqenie Sociale MPMS.
- Leja e Qarkullimit të automjetit
- Patentë shoferi.
- Libreza e HANDIKOS-it
- Atesti nga organi kompetent, që vërteton se automjeti i përshtatet për ngasje personit me nevoja të veçanta.
- deklaratë me shkrim se nuk ka shfrytëzuar asnjëherë më herët këtë të drejtë.

Vërejtje: Automjetet e liruara nga detyrimet doganore “Nuk mund të huazohen, të jepen me qira apo të transferohen te personat e tjerë”;

Importet nga organizatat – Karroca, gjësende për persona të hedikepuar

Baza ligjore: Kodi Nr. 03/L-109, Doganor dhe i Akcizave Në Kosovë, Aneksi 'A' Neni 76, paragrafi 1, neni 78.

Dokumentet e nevojshme:

- një dokument (Certifikatë) që vërteton statusin e subjektit, organizatës apo entit për ofrim të ndihmës apo asistencës tjetër rehabilituese.
- një deklaratë me shkrim që mallrat e importuara të destinuara vetëm për përdorim, ose për të ofruar ndihmë dhe rehabilitimin falas për persona me aftësi të kufizuara,
- në raste të donacionit **Akt dhurimi** (origjinal) me referencat mbi **titullarin/pranuesin e donacionit**, fatura, apo çfarëdo dokumenti tjetër kur dogana e konsideron të nevojshëm.).
-Vërejtje: Ne rastet specifike Dogana mund të kërkojë dokumente shtesë varësisht nga llojet e mallrave të cilat importohen.

a) invalidët e luftës : Automjetet

- leja e qarkullimit të automjetit,
- patentë shoferi,
- kartela e anëtarësisë e UÇK-së
- vërtetim nga Organizata e Veteranëve të Luftës për lirim të automjetit nga dogana.

– vendimin nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS) që vërteton se kërkuesi është përfitues i pensionit invalidor (vendimi të shoqërohet edhe me mendimin e konzoliumit të mjekeve) .

– deklarate me shkrim e nënshkruar nga përfituesi i lirimit që deklaron se nuk ka shfrytëzuar asnjëherë më herët këtë të drejtë.

Baza ligjore Kodi Nr. 03/L-109, Doganor dhe i Akcizave Në Kosovë, neni 4,Paragrafi 10; KDA Aneksi A: neni 76, paragrafi 1, neni 78, paragrafi 1 pika ‘b’ dhe Neni 134, paragrafi f). Ligji Nr. 04/L-054, neni 1 paragrafi 1.7 dhe neni 6 paragrafi 2 i Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve.

Vërejtje: Automjetet e liruar nga detyrimet doganore “Nuk mund të huazohen, të jepen me qira apo të transferohen te personat e tjerë”;

Mallra për organizata humanitare ose bamirëse; mallra të destinuar për të verbëritë dhe personat tjerë të hendikepuar, karroca, gjësende për persona të hendikepuar

– një dokument (Certifikatë) që vërteton statusin e subjektit, organizatës apo entit për ofrim të ndihmës apo asistencës tjetër rehabilituese.

– një deklaratë me shkrim që mallrat e importuara të destinuar vetëm për përdorim, ose për të ofruar ndihmë dhe rehabilitimin falas për persona me aftësi të kufizuara,

– në raste të donacionit **Akt dhurimi** (origjinal) me referencat mbi **titullarin/pranuesin e donacionit**, fatura, apo çfarëdo dokumenti tjetër kur dogana e konsideron të nevojshëm.).

Baza ligjore Kodi Nr. 03/L-109, Doganor dhe i Akcizave Në Kosovë, Aneksi ‘A’ Neni 76, paragrafi 1, neni 78.